



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KRUJË

Njoftim në lidhje me shkaqet e ankimit që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë ka bërë ndaj vendimit nr.6/123 datë 14.01.2020 të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Krujë në lidhje me kërkesën për lirim me kusht të dënuarit Endrit Dokle

Brenda afatit ligjor organi i akuzës ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr.6/123 datë 14.01.2020 të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Krujë, duke rezervuar të drejtën për të plotësuar ankimin pasi të njihet me arsyetimin, duke parashtruar shkaqet për sa më poshtë vijon:

I. Në lidhje me shkeljet proceduriale :

Prokuroria ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës së çështjes, me arsyetimin se pasi është njohur me fashikullin e gjykimit ka rezultuar se i njëjti trup gjykues ka gjykuar kerkesa të tjera penale si ndryshimi i llojit të sigurisë së burgut, njohje paraburgimi, amnistisë, etj, dhe krijoi bindjen e plotë se ky trup gjykues ka paragjykuar çështjen. Fakte këto që tregonin se kjo gjyqtare nuk krijonte besimin e duhur për të vazhduar të shqyrtonte këtë çështje.

Gjykata ka rrëzuar kërkesën për të cilën nuk jemi njohur me vendimin e arsyetuar, por vlersojmë se në këtë proces nuk u garantua e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe të paanshëm në përputhje me nenin 42/2 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Sjellim në vëmendje të Gjykatës, se Gjykata Kushtetuese në praktikë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit.

Kështu, ajo ka theksuar se në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: **i pari**, konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në një çështje konkrete. Ndërsa testi **i dytë** lidhet me vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (*Shih vendimin nr.18/2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Përsa i perket testit të objektivitetit Gjykata e Strazburgut ka theksuar në çështjen deklaroi *Fey kundër Austrisë*¹ se: “ Në bazë të testit të objektivitetit duhet të përcaktohet nëse, përveç faktit

¹ Fey kundër Austrisë, 24.02.1992,nr. Aplikimit 14396/88. par. 30

të sjelljes personale të gjyqtarit, ekzistojnë fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime përse i perket paanshmerisë së tij” Faktet të cilat iu parashtruan gjykatës ishin të mjaftueshme dhe tërësisht të verifikueshme si për faktin e dhënies së vendimeve në favor të kërkuesit ashtu dhe të kohës së dhënies së tyre. Në rastin konkret gjyqtarja nuk ofronte garanci për të qenë e panashme.

Ndërsa në lidhje me efektet që sjell shkelja e parimit të procesit të rregullt ligjor sjellim në vëmendje çështjen **Karttunen kundër Finlandës**, ku Gjykata u shpreh se nëse rastet për përjashtimin e një gjyqtari janë përcaktuar shprehimisht në ligj, gjykata duhet t'i konsiderojë ex officio këto raste dhe duhet të zëvendësojë anëtarin e trupit gjykues për të cilin gjëndet një nga këto raste.²**Një gjyq i cili zhvillohet me pjesëmarrjen e një gjyqtari, për të cilin u gjënden raste skualifikimi, nuk mund të konsiderohet i drejtë.** Për të vendosur nëse në një çështje konkrete ekzistojnë apo jo arsye për të besuar se një gjyqtar mund të mos jetë i paanshëm, qëndrimi i kërkuesit është i rëndësishëm por jo vendimtar. Vendimtar është fakti nëse kjo frikë mund të justifikohet objektivisht.³

Pikërisht faktet e mësipërme Prokuroria kishte humbur besimin se kjo çështje mund të gjykohej në mënyrë të paanshme nga kjo gjyqtare.

Në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit tek gjyqësori me qëllim që **drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që po bëhet.** Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë (*Shih vendimin nr.16/2003 të Gjykatës Kushtetuese*)

Në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit tek gjyqësori me qëllim që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që po bëhet. Është pikërisht kjo mungesë e besimit tek palët që mund të çojë në krijimin e bindjes tek ta se nuk do të kenë një proces të rregullt ligjor, pasi ky gjyqtar nuk arrin ta përçojë këtë siguri si në rastin konkret dhe cënon gjithë procesin dhe vendimamarrjen.

II. Në lidhje me kërkesën për “lirimin me kusht”.

Në kreun VII, nenet 58, 59, 59/a, 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65 të Kodit Penal parashikohen “Alternativat e dënimit me burgim”. Këto alternativa janë njohur në Kodin Penal me miratimin e kodit të ri në vitin 1995. Rastet që parashikojnë nenet e sipërpërmendura nuk janë llojet të reja dënimesh. Në këto raste, dënimi është vetëm një: burgimi. Nenet 59 – 65 të Kodit Penal parashikojnë format apo mënyrat e veçanta të vuajtjes së këtij dënimi.

Një nga alternativat e dënimit me burgim është “Lirimi me kusht”. Kështu, në nenin 64 të Kodit Penal parashikohet shprehimisht se: “I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me

²Karttunen kundër Finlandës, datë 23.10.1992, komunikatë nr. 387/1989, par.7.2

³ Hauschildt kundër Danimarkës, par.48

dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur: - jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale; - jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim; - jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi 5 vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni. Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje. Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarin për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100. Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve. Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimit për lirimin para kohe me kusht.” Ndërsa sipas nenit 65 të kodit penal kushtet e tjera janë : - të ketë vuajtur jo më pak se 35 vite burgim; - gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore; çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij. Nga përmbajtja e kësyre dispozitave që rregullojnë institutin e lirit me kusht rezulton se një nga kushtet thelbësore për aplikimin e lirit me kusht është plotësimi i kohës së vuajtjes së dënimit dhe identifikimi i “arsyeve të veçanta” apo “sjellja shembullore” që tregojnë se me sjelljen dhe punën e tij, i dënuari tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

1. Në lidhje më periudhën e vuajtjes së dënimit vlerësojme se:

Kërkuesi nuk ka përmbushur kriterin formal, që kërkon neni 65 i Kodit Penal, lidhur me kohën efektive të vuajtjes së dënimit, sepse përrllogaritjes së periudhës së dënimit të vuajtur nga i dënuari deri më datën e raportit (në ditë, muaj, vite) janë përkatësisht 25 vjet e 6 muaj e dhjetë ditë dukë përfshirë periudhën e amnistisë e njohur me vendim gjykate përkatësisht 4 vite. **Sipas ligjas në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje. Pra për sa më sipër nuk provohet e plotësuar kushti kryesor e cila përbën një parakusht procedural pa të cilën gjykata nuk mund të analizojë arsyet e veçanta që të legjitimojnë lirimin e tij përpara se të përfundojë dënimin e dhënë për të. Lirimi me kusht është një institut që vlen si mjet i jashtëzakonshëm i ndërprejes së mëtejshme të dënimit, vetëm në rastet e parashikuara në ligj të cilat vlerësohen dhe konsiderohen prej Gjykatës në mënyrë kumulative.** Në këtë kuptim, çdo i dënuar në parim, do të duhet të vuajë dënimin e plotë sikurse ka vendosur gjykata dhe vetëm përjashtimisht, për arsye të veçanta mund të lejohet që ky dënim të ndërpritet përpara se të përfundojë krejtësisht. Sikurse u theksua më sipër, kërkuesi nuk provoi plotësimin e afatit që të mund të vlerësohet si e tillë dhe kësaj kërkesa do të konsiderohet si e pambështetur në ligj e në prova dhe si e papranueshme.

Kërkuesi është përsëritës për krime të kryera me dashje, sepse me vendimin nr.29 dt 15.04.2013 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka deklaruar fajtor për veprën penale “Grup i strukturuar kriminal “parashikuar nga neni 333/a/1 i Kodit Penal dhe trafikimi i narkotikëve në kuadër të grup i strukturuar kriminal parashikuar nga neni 283/a/2 dhe 334/1 i Kodit Penal duke e dënuar me 16 vite burgim gjatë kohës që ishte i dënuar për veprat e kryera

në vitin 2005. Këto kushte nuk lejojnë vlerësimin e arsyeve të veçanta apo sjelljes shëmbullore. Jane kushte *sine qua non* pa të cilat kërkesa duhet të rrëzohej.

3. Identifikimi i “arsyeve të veçanta” si një nga kushtet thelbësore për aplikimin e liritimit me kusht vlerësojme se:

Në nenin 64 të kodit penal parashikohet se: *“I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e tij i është arritur qëllimit për edukimin e tij si dhe të ketë vuajtur :*

-jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundravajtje penale;

-jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

-jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi mbi pesë vjet deri në maksimumin e parashikuar nga ligji, me përjashtim të parashikimeve në paragrafin 3 të këtij neni.

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje; si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimit për lirimin me kusht.”

Në nenin 65 të kodit penal, ndryshuar paragrafi I, II me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008; ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017, sanksionohet se:

“1. Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm.

*2. Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur: **Ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim dhe gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shëmbullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.***

3. Nga ky rregull, përjashtohen të dënuarit për veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafi i tretë i nenit 100.”

Ndryshimet që ka pësuar kodi penal me ligjin nr. 36 datë 30.03.2017 janë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98 në datën 05.05.2017 dhe kanë hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

Në referim të Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2 datë 25.05.2015 sipas të cilit :

“... Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se:

Ligjvënësi duke përdorur shprehjen “arsye të veçanta” ka bërë një vlerësim të përgjithshëm, pa i nominuar ato e duke e lënë në vlerësim të gjykatës sipas rrethanave konkrete që i paraqiten. Megjithatë, këto “arsye të veçanta” nuk janë të pavarura dhe duhet të jenë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të liritimit para kohe me kusht i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin

dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 64 të Kodit Penal të çon në konkluzionin logjik se kemi të bëjmë me një kusht të vetëm dhe “arsyet e veçanta” nuk janë gjë tjetër veçse fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. ...”

Në pjesën analizuese Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çështjet që gjykatat duhet të vlerësojnë në shqyrtimet e kërkesave me objekt lirim me kusht në tërësi si institut janë : 1) Natyra e veprës penale të kryer dhe sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit, faktin nëse ajo është kryer në bashkëpunim, me paramendim, apo me dhunë etj. 2) Qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës dhe se pendimi i të dënuarit duhet të rezultojë nga të dhëna objektive. 3) Ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej të dënuarit. 4) Gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, që nënkupton se nëse i dënuari ka një gjendje të rënduar fizike apo moshë të madhe, kjo rrethanë do të konsiderohet në favor të të dënuarit, jo vetëm për arsye humanitare, por edhe pasi rrezikshmëria shoqërore në këtë rast do të cilësohet si më e ulët. 5) Dinamika e sjelljes së të dënuarit në I EVP që nënkupton zbatimin me korrektësi maksimale të rregullores së brendshme të I EVP-së, por edhe që i dënuari të tregojë konkretisht, se gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, sjellja e tij ka qenë e tillë sa për të çuar drejt përfundimit se i dënuari vërtet ka treguar pendim, duke u sjellë me korrektesë me bashkëvuajtësit; autoritetet e I EVP-së; ka mbajtur (ose tentuar të mbajë) marrëdhënie të rregullta me familjaret e tij; ka normalizuar (ose tentuar t’i normalizojë) marrëdhëniet me personin e dëmtuar/viktimën dhe familjen e tij, si dhe ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; si dhe ka marrë pjesë në aktivitete pune, trajnuese, kulturore dhe edukative. 6) Raporti i autoriteteve të I EVP-së në të cilën vuan dënimin kërkuesi, është me rëndësi për gjykatën për sa i përket analizës së saj në lidhje me riedukimin e të dënuarit. **Për t’u konsideruar si i riedukuar, i dënuari nuk duhet thjesht dhe vetëm të këtë respektuar rregulloren e I EVP-së gjatë vuajtjes së dënimit, por të jetë aktivizuar duke marrë pjesë në aktivitete riedukuese, kulturore, trajnuese, punësimi, përmes të cilave të kuptohet pendimi i të dënuarit në raport me veprën e kryer dhe riedukimi i tij.** 7) Gjykata ndihmohet nga raporti i Shërbimit të Provës që duhet të përmbajë (i) kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe (ii) planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirit. 8) Në lidhje me kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, Kolegjet kanë theksuar se kushtet e vështira ekonomike apo gjendja e rëndë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit, ndërkohë që në raste dhe rrethana të caktuara mund të merren në konsideratë si element potencial për efekt të uljes së rrezikut të recidivizmit, **ato nuk duhet kurrësi që të konsiderohen, në vetvete, si element në disfavor të pranimit të kërkesës për lirim me kusht.** 9) Për sa i përket planeve konkrete të të dënuarit për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirit, Kolegjet kanë theksuar se ato duhet të jenë sa më realiste, në raport me mundësitë efektive të të dënuarit, dhe duhet të shërbejnë për të bërë sa më të lehtë tranzicionin që i dënuari kalon në periudhën menjëherë pas lirit.

Në interpretim të dispozitave të sipërcituara dhe duke patur në vëmendje Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ndaj një të dënuari mund të aplikohet si dënim

alternativ lirimi me kusht **nëse plotësohen** këto kushte:

Së pari, ekzistenca e arsyeve të veçanta apo sjelljes shëmbulllore. Në nenin 64 po dhe në interpretim qëllimor dhe sistematik të nenit 65 të kodit penal (së bashku lidhen me të njëjtin institut) nuk janë përcaktuar rastet që konsiderohen si “*arsye të veçanta*” por referuar qëndrimin të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë “*arsyet e veçanta*” nuk janë të pavarura, ato janë të lidhura ngushtë me qëllimin e institutit të lirimit me kusht i cili ka të bëjë me riedukimin dhe riintegrimin në shoqëri të të dënuarit. Arsyet e veçanta nuk janë gjë tjetër veçse rrethana konkrete, të cilat provojnë se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin dhe i dënuari është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Ato janë fakte të cilat provojnë se me pjesën e dënimit të vuajtur është arritur qëllimi i dënimit penal në rastin konkret për edukimin e të dënuarit dhe ai është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri.

Në rastin konkret nuk ka fakte që qëllimi i dënimit penal është realizuar me riedukimin e tij .

- a) Së pari kërkuesi është dënuar për vrasje me paramendim dhe krime të tjera të rënda.
- b) Së dyti, i dënuari e ka kryer në bashkëpunim si dhe ka qënë pjesë e formacione të bashkëpunimit të vecantë si “grup i strukturuar kriminal”
- c) Së treti, lidhur me qëndrimin që ai ka pasur ndaj veprës në përfundim të gjykimit ka kërkuar pafajësi. Pra, nuk e ka pranuar veprën.

Sa më sipër, duke pasur parasysh rrezikshmërinë e veprës penale të cilën ka konsumuar i dënuari fakti që veprë të rëndë kundër jetës të cilën ai është dënuar, faktin që ajo e ka kryer veprat me dashje direkte dhe në bashkëpunim si dhe faktin që ka mbajtur qëndrim mohues për veprën, nuk krijon bindjen e brendshme se kërkuesi ja ka arritur qëllimin e dënimit për të liruar para kohe.

Së dyti, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin i është arritur qëllimit për edukimin e tij. Sjellja e të dënuarit vlerësohet për tërë kohën e dënimit të vuajtur dhe Gjykata mban parasysh respektimin e rregullores brenda institucionit, ekzistencën ose jo të masave disiplinore, marrëdhëniet e krijuara me bashkëvuajtësit e personelin e institucionit, qëndrimin e të dënuarit ndaj veprës penale, angazhimin e tij në aktivitetet sportive, kulturore, fetare, pjesëmarrjen në këshillimet individuale apo në grup, ndjekja e kurseve arsimore e profesionale me qëllim rritjen e nivelit arsimor, profesional e kulturor, marrja e lejeve shpërblyese etj. Provat në të cilat bazohet Gjykata për të konkluduar nëse me sjelljen e qëndrimin e tij është arritur qëllimi i edukimit janë aktet që gjenden në dosjet e të dënuarit dhe regjistrat përkatës që mbahen në çdo I.E.V.P në respektim të VKM-së nr.303, datë 25.03.2009 “*Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve*”.

Fakti që kërkuesi nuk shprehet për pëndësë e bën dhe raportet e shërbimit të provës dhe IEVP, në lidhje elementin e riedukimit të të dënuarit Endrit Dokle, të pa plota për të vlerësuar qëllimin e riedukimit të tij. Gjithashtu nuk shpjegohet se ku bazohet ky qëndrim kur sipas avokatit të kërkuesit në seance deklarohet se ky shtetas vuan nga semundje depresive, si dhe gjatë intervistave në IEVP i dënuari nuk pranon përgjegjësinë kryesore për disa vepra për të cilat është dënuar (lexo faqe 8 të Raportit të shërbimit të Provës).

Ajo që duhet të vlerësohet dhe të analizohet nga instiucionet e mësipërme dhe prej gjykatës është dhe fakti se kërkuesi është dënuar pra është përsëritës dhe me vendimin nr.29 dt 15.04.2013 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ,e cila ka deklaruar fajtor për veprën penale “*Grup i strukturuar kriminal* “parashikuar nga neni 333/a/1 i Kodit Penal dhe trafikimi i

narkotikëve në kuadër të grup i strukturuar kriminal parashikuar nga neni 283/a/2 dhe 334/1 i Kodit Penal duke e dënuar me 16 vite burgim.

Së treti: në rastin e të dënuarit me burgim të përjetshëm ligjvënësi ka sanksionuar se si rregull lirimimi i tyre me kusht nuk lejohet, përjashtimisht lirimimi i tyre lejohet nëse lotësohen disa kondita të tjera të cilat sipas nenit 65 të kodit penal janë : - të ketë vuajtur jo më pak se 35 vite burgim; - gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore; çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij. Në çdo rast lirimimi i një të dënuari me burgim të përjetshëm konsiderohet si i jashtzakonshëm. **Në vijim, nëse i dënuari është duke vuajtur dënimin për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafi i tretë i nenit 100 dhe rezulton të jetë dënuar me burgim të përjetshëm, lirimimi i tij nuk lejohet pavarësisht se ai plotëson të gjitha konditat e tjera ligjore siç janë koha e vuajtjes së dënimit, sjellja e tij apo fakti se është arritur qëllimi i edukimit të tij.**

Në çështjen objekt gjykimi rezultoi se kërkuesi nuk plotësonte kushtet e përmendura më lart çka nënkupton se :nuk provohet ekzistenca e arsyeve të veçanta apo sjelljes shembullore, nuk ka vuajtur as 25 vite sipas ligjit para ndryshimeve dhe as 35 vite sipas ligjit në fuqi nga dënimi i dhënë. Në rastin konkret duhen hequr kohën e përfituar me amnisti rreth 5 vite, kështu kërkuesi konsiderohet se ka vuajtur për efekt të nenit 64 dhe **65 të K.Penal rreth 20 vite pra nuk ka plotësuar kohën e vuajtjes së dënimit.**

Gjatë këtij gjykimi është administruar raporti i vlerësimit nga ana e Shërbimit të Provës me nr. 621/2 datë 02.12.2019 sipas të cilës qëndrimi i këtij institucioni është për sa më poshtë vijon: *“Shërbimi i Provës, në cilësinë e institucionit misioni i të cilit, bazuar në ligjin procedural dhe kriteret e ligjore , është në mbështetje të çdo kërkesë për aplikim të dënimeve alternative dhe mbikqyrja, mbështetja, asistimi i të dënuarve gjatë procesit të rehabilitimit dhe risocializimit. Në fund të realizimit të këtij qëllimi, Shërbimi i provës , nga Gjykata do ta gjykonte të arsyeshme pranimin e kërkesës së të dënuarit Endrit Dokle, është dakort dhe do ta mbështeste këtë vendim dhe në përmbushje të detyrave funksionale do ta ndihmonte dhe asistonte të dënuarin gjatë procesit të rehabilitimit të tij, pranë familjes”*

Sipas avokatit të të dënuarit deklaroi se ai vuan nga sëmundje depresive për të cilën gjykata duhet të kishte caktuar ekspert mjekoligjor mbi këtë fakt. Nisur nga qëndrimi i mjekut gjykata duhet të vlerësojë të lejojë që dënimi me burgim të ekzekutohet jo në një I.E.V.P apo në një qendër të kujdesit dhe shëndetit publik nëse provohej sëmundja mendore, për të cilën pa u hetuar ky shkak krijon premisa jo të sakta mbi rrezikshmërinë e kërkuesit. Është Gjykata më pas në kuadër të çmuarjes së provës pa i dhënë asnjë provë vlerë të paracaktuar të analizojë në tërësi dhe të vendosë mbi kërkesën e palës.

Së katërti : Në lidhje me kohën e vendosjes në shërbim në provë gjykata ka vendosur vendosjen në periudhë provë për një periudhë prej 5(pesë) vjetësh, që është në kundërshtim me Vendimin Unifikues sipas të cilit orienton gjykatata me efekt të detyrueshëm për zbatim : *“Në mungesë të një rregullimi të saktë ligjor, koha e provës do të jetë e barabartë me kohën e mbetur të masës së dënimit me burgim, për të dënuarin që lirohet me kusht.” Pra gjykata ka gabuar në zbatimin për analogji të kohës e caktuar duke referuar parashikimet tek neni 59 i Kodit Penal dhe ka caktuar në mënyrë joproporcionale dhe ligjore kohën e shërbimit në provë vetëm për 5 vite.*

Për këto arsye, organi i akuzës çmon se kërkesa është e pabazuar ligjerisht në bazë të nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, ndaj edhe **duhej të rrëzohej nga gjykata dhe rrjedhimisht vendimi gjyqësor për pranimin e kërkesës së të dënuarit është i pabazuar në ligj dhe prova dhe duhet të ndryshohet**

Përfundimisht është kërkuar: **Ndryshimi i vendimit nr.6/123 Akti. datë 14.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Rrëzimi i kërkesës së të dënuarit Endrit Dokle për “Lirimin me kusht ” si të pa bazuar në ligj dhe në prova.**

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KRUIË